

VENDIM
Nr.455, datë 18.7.2007

PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PYJOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e shërbimit pyjor janë, përkatësisht, sipas lidhjes nr.1 "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e shërbimit pyjor", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Punonjësve të shërbimit pyjor, që marrin pagat sipas lidhjes nr.1 të këtij vendimi, për çdo vit pune, u jepet shtesë mbi pagën bazë mujore, në masën 1 (një) për qind, për çdo vit pune, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese të njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

3. Punonjësve të shërbimit pyjor, që marrin pagat sipas lidhjes nr.1 të këtij vendimi, për funksion drejtues, u jepet shtesë, mbi pagën bazë mujore, në masën 5 - 40 për qind mbi pagën bazë për klasë, sipas grupimit të mëposhtëm:

Grupi i parë	deri në 5;
Grupi i dytë	5 deri në 10;
Grupi i tretë	10 deri në 15;
Grupi i katërt	15 deri në 20;
Grupi i pestë	20 deri në 30;
Grupi i gjashtë	30 deri në 40.

4. Drejtori i Departamentit të Administratës Publike dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për punonjësit e drejtorive të shërbimit pyjor, sipas vendit të punës, nivelit arsimor, vështirësisë në detyrë dhe rrethanave të tjera, të kësaj natyre.

5. Për kushte të veçanta të shërbimit, punonjësit e shërbimit pyjor përfitojnë shtesë mbi pagë bazë, deri në 30 për qind. Masa e shtesës, për çdo vend pune, caktohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

6. Vendimi nr.185, datë 16.4.1993 i Këshillit të Ministrave "Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor", i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT
PYJOR

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	16000
2.	II	16300
3.	III	16500
4.	IV	17200
— 5.	V	17700
6.	VI	18100
7.	VII	18700
8.	VIII	19100
9.	IX	19400
10.	X	20200
11.	XI	20650
12.	XII	21000
13.	XIII	21300
14.	XIV	21600
15.	XV	21900
16.	XVI	22250
17.	XVII	22650
18.	XVIII	23100
19.	XIX	23200
20.	XX	25000
21.	XXI	25600
22.	XXII	27860
23.	XXIII	32860